



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 54, datë 10.09.2025

PËR MIRATIMIN E MANDATIT TË ANËTARES SË KËSHILLIT BASHKIAK
ZNJ. MIRELA RASIM SHALA

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, nenit 49, pika 1 dhe pika 2, nenit 50, nenit 54, pika “j”, nenit 55, pika 3 dhe 6, të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, të Rregullores së Funksiomit të Këshillit Bashkiak, shkresës të Komisionit Qëndror Zgjedhor me nr.prot 5671, datë 23.07.2025, protokolluar me tonën nr.9230 prot., datë 28.07.2025, mbështetur në raportin e Komisionit të Mandateve si dhe pas betimit në Këshillin Bashkiak Durrës, në mbledhjen e datës 10.09.2025,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak Durrës, kandidate në listën shumemërore të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, znj. Mirela Rasim Shala.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sekretari i Këshillit Bashkiak.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 10.09.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Datë 10 / 09 /2025

FORMULA E BETIMIT

Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”,
i ndryshuar, nënshkruhet “Formula e Betimit” si më poshtë :

“Betohe me në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të Këshillit Bashkiak dhe
do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohe me se në të gjithë veprimtarinë time do të
udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Durrës dhe do të punoj me ndershmëri e
përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

Emër Mbiemër

Mirela Shala

Firmë :





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 600 / prot.

Durrës, më 12.09.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.54 datë 10.09.2025 ,” Për miratimin e mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak znj. Mirela Rasim Shala”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

